



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLIK E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinesica Org.Unit	SP-02
Nr i faqeve Bc.Stranica No.Pages	05
Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	726-2/23
Data: Datum: Date:	22.05.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	22.05.2023
REFERENC-Ë:	23/726/MMPHI
PËR/ZA/TO:	" Ex Fis"Sh.p.k.Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 23/726/1-76/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për stacionin e karburantëve në Llapushnik, , Glllogoc

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania " Ex Fis"Sh.p.k.Prishtinë pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për stacionin e karburantëve në ngastrat kadastrale nr.00874-1 dhe nr.00875-1, Z.K. Llapushnik, Komuna e Gllogocit, me kapacitet të rezervuarëve V1=60.000 , V2=60.000 , V3=42.000 dhe V=25.000 litra litra naftë dhe benzin nën kushtet si vijon:

- Të ndërtohet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore, nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza (seperator për vajra dhe gropa septike) adekuate me standarde dhe konform ligjit;
- Gjatë punës (shërbimit) me pompa, duhet të shtohet kujdesi për evitimin e derdhjes së vajit motorik mbeturinë, vajit ushqimor mbeturinë;
- Të betonohet dhe izolohet platoja ku do të vendosen vaji motorik mbeturinë, vajit ushqimor mbeturinë
- Të betonohet dhe izolohet platoja e sipërfaqeve operationale;

Faqe 2 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



- Të sigurohen kontejner për grumbullimin e mbeturinave të amvisorisë në mënyrë që ambienti rreth lokalitetit të jetë çdo herë i pastër;
- Të përgatitet dhe implementohet plani aksional për raste aksidenti.
- Menaxhimi i mbeturinave, të bëhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina;
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terenit dhe rregullimi i rrethojës së terenit të objektit për grumbullimin, mbledhjen, transportimin dhe magazinimin e vajit ushqimor të përdorur;
- Bazuar në Ligjin e Ujrave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Ndalohet veprimtaria e kompanisë "Ex Fis" Sh.p.k. Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor për stacionin e karburantëve në ngastrat kadastrale nr.00874-1 dhe nr.00875-1, Z.K. Llapushnik, Komuna e Glogocit në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit,

Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (merret).



A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM/VSM, dokumantacionit përcjellës të dorëzuar, nga kompania " Ex Fis" Sh.p.k. Prishtinë për Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për stacionin e karburantëve në ngastrat kadastrale nr.00874-1 dhe nr.00875-1, Z.K. Llapushnik, Komuna e Glllogocit, me kapacitet të rezervuarëve V1=60.000 , V2=60.000 , V3=42.000 dhe V=25.000 litra litra naftë dhe benzin, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerr Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet , konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM Nr. 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 22/726/1 - ZSP/185/23 datë: 22.05.2023

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrisë
5. Divizionit për komunikim me publikun
6. Arkivit të MMPHI

Servet Spahiu

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPHI



2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të fillojë veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. i Prot. Org. Unit No. i Fajqeve It. Stranica No. Pages	DMMU 15
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. Data Datum Date	226-2/23 22.05.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/ Department of Environment Protection and Waters/
Departament za Zaštitu Sredine i Voda

REFERENCE:	23/726/1-76/DMMU				
PËR/ZA/TO:	Servet Spahiu zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ismail HETEMAJ, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU <i>[Signature]</i>				
NGA/OD/FROM:	Visare Istrefi, U.D, Udhëheqëse e DMNI-së <i>[Signature]</i>				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Naim Alidema , zyrtar i lartë për VNM/VSM <i>[Signature]</i>				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	1517	Lokacioni: Kucni: Extension:	Ish Pallati i Mediave, Rilindja Prishtinë.	Data: Datum: Date:	22.05.2023
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☒
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☒
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☒
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☒
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Kompania " Ex Fis"Sh.p.k.Prishtinë ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor me nr.prot. 23/726/1-76/DMMU, të dt. 14.02.2023. Kërkesës për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Raportin e VNM-së e plotësuar në katër kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD) i nëshkruar dhe i vulosur nga bartësi i projektit ;
- Vertetim Urbanistik nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Drenasit.
- Pëlqimi nga MPB-Agjencia e Menaxhimit Emergjent
- Fatura e pageses së shërbimit për pëlqim mjedisor
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Kopja e Planit
- Certifikata e pronësisë
- Plani i situacionit nga Gjeodetii licencuar
- Kontrata për qiranë

Komisioni për Vlerësim të Raporteve të VNM-së ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar, të kompanisë " Ex Fis"Sh.p.k.Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor për stacionin e karburantëve në ngastrat kadastrale nr.00874-1 dhe nr.00875-1, Z.K. Llapushnik, Komuna e Glllogocit, me kapacitet të rezervuarëve $V1=60.000$, $V2=60.000$, $V3=42.000$ dhe $V=25.000$ litra litra naftë dhe benzin.

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM , neni 16 , është mbajtur debati publik, me dt. 26.04.2022.

Ne debat publik nuk kishte pjesëmarrës nga qytetaret perveq Hartuesi i raportit te VNM-së dhe Pronari i Kompanisë.

Bazuar në nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 , Komisioni për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis rekomandon që ti Lëshohet Pëlqimi Mjedisor Kompanisë " Ex Fis"Sh.p.k.Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor për stacionin e karburantëve në ngastrat kadastrale nr.00874-1 dhe nr.00875-1, Z.K. Llapushnik, Komuna e Glllogocit, me kapacitet të rezervuarëve $V1=60.000$, $V2=60.000$, $V3=42.000$ dhe $V=25.000$ litra litra naftë dhe benzinnën kushtet si vijon:


- Të ndërtohet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore, nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza (seperator për vajra dhe gropa septike) adekuate me standarde dhe konform ligjit;
- Gjatë punës (shërbimit) me pompa, duhet të shtohet kujdesi për evitimin e derdhjes së vajit motorik mbeturinë, vajit ushqimor mbeturinë;
- Të betonohet dhe izohet platoja ku do të vendosen vaji motorik mbeturinë, vajit ushqimor mbeturinë.
- Të betonohet dhe izohet platoja e sipërfaqeve operacionale;
- Të sigurohen kontejner për grumbullimin e mbeturinave të amvisrisë në mënyrë që ambienti rreth lokalitetit të jetë çdo herë i pastër;

- Të përgatitet dhe implementohet plani akcional për raste aksidenti.
- Menaxhimi i mbeturinave, të bëhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina;
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terenit dhe rregullimi i rrethojës së terenit të objektit për grumbullimin, mbledhjen, transportimin dhe magazinimin e vajit ushqimor të përdorur;
- Bazuar në Ligjin e Ujrave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Ndalohet veprimtaria e kompanisë "Ex Fis" Sh.p.k. Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor për stacionin e karburantëve në ngastrat kadastrale nr.00874-1 dhe nr.00875-1, Z.K. Llapushnik, Komuna e Gllogocit në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit,

Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (merret).

Komisioni:

Naim Alidema, kryesues 
 Malsore Jonuzi, anëtare 
 Valmira Gashi/Lipaj, anëtare

Abdullah Pirçe, anëtar 
 Ibrahim Balaj, anëtar

Zyrtari Ibrahim Balaj anëtare e komisionit për VNM nuk e ka nënshkruar përgjigjen e komisionit pasi që bazuar në pikën 1.4 dhe 1.5 të Vendimit Nr. 272/2022 merre pjesë vetëm në shqyrtimin e raporteve që kanë të bëjnë vetëm me fushën e mbeturinave

Me respekt,

Naim Alidema

Zyrtar i lartë për VNM/VSM

Divizioni për Menaxhimin e Ndotjes Industriale

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

Adresa: Rruga Luan Haradinaj (ish Pallati i Mediave Rilindja)

Kati XV, 10000 Prishtinë, Kosovë

☐: 038 200 327 06

☐: naim.alidemaj@rks-gov.net

Zyrtarja Valmire Gashi-Lipaj anëtare e komisionit për VNM ka dhënë dorëheqje ,
kjo është arsyeja pse mungojn nënshkrimet e zyrtareve në fjalë.

Me respekt,

Naim Alidema

Zyrtar i lartë për VNM/VSM

Divizioni për Menaxhimin e Ndotjes Industriale

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

Adresa: Rruga Luan Haradinaj (ish Pallati i Mediave Rilindja)

Kati XV, 10000 Prishtinë, Kosovë

☐: 038 200 327 06

☐: naim.alidemaj@rks-gov.net